

LIGJI Nr. 05/L-110

PËR KAMATË-VONESAT NË TRANSAKSIONET TREGTARE

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR KAMATË-VONESAT NË TRANSAKSIONET TREGTARE

Neni 1

Qëllimi

1. Qëllimi i këtij ligji është parandalimi i vonesave të pagesave në transaksionet tregtare, si dhe përcaktimi i rregullave për afatet dhe mënyrën e llogaritjes së kamatë-vonesave, në rastet e furnizimit me mallra dhe shërbime në mes të shoqërive tregtare ose në mes të shoqërive tregtare dhe autoriteteve publike, në mënyrë që të sigurohet funksionimi i duhur i tregut, duke nxitur aftësinë konkurruese të shoqërive tregtare.

2. Ky ligj është pjesërisht në përputhje me Direktivën 2011/7/EU të Parlamentit dhe Këshillit Evropian, të datës 16 shkurt 2011, për “Luftën Kundër Pagesave të Vonuara në Transaksionet Tregtare”, Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, nr. 48, datë 23.2.2011, f. 1–10.

Neni 2

Fushëveprimi

1. Ky ligj zbatohet për të gjitha pagesat e kryera, në kompensim për punët juridike tregtare.

2. Ky ligj nuk zbatohet për detyrimet apo pagesat për punët juridike tregtare si në vijim:

2.1. që janë objekt i procedurës së falimentimit të hapur kundër debitorit, përfshirë edhe rastet e ristrukturimit të borxhit;

2.2. që rrjedhin nga kontratat me konsumatorët.

2.3. kamatë-vonesa për transaksionet mes personave fizikë dhe juridikë me institucionet financiare të licencuara në Kosovë, që rregullohet me akt nënligjor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK).

Neni 3

Përkufizimet

1. Përkufizimet e përdorura në këtë ligj kanë këto kuptime:

1.1. **Transaksionet tregtare** - transaksionet mes shoqërive tregtare në njërën anë apo mes shoqërive tregtare dhe autoriteteve publike në anën tjetër, që shpiejnë në

dorëzimin e mallrave ose kryerjen e shërbimeve kundrejt një pagese.

1.2. **Autoritet publik** - çdo autoritet kontraktues publik, ku përfshihen njësitë e qeverisjes qendrore, njësitë e vetëqeverisjes lokale, ndërmarrjet publike dhe të gjitha institucionet e krijuara sipas Kushtetutës së Kosovës, pa marrë parasysh vlerën e kontratës;

1.3. **Shoqëri tregtare** - çdo shoqëri tregtare e themeluar sipas Ligjit përkatës për Shoqëritë Tregtare;

1.4. **Pagesë e vonuar** - pagesa që nuk kryhet brenda periudhës kontraktuese apo ligjore të paraparë për pagesë dhe kur përmbushen kushtet që janë paraparë në nenet 4 dhe 5 të këtij ligji;

1.5. **Kamatëvonesë** – interesi ligjor për pagesën e vonuar apo kamatën në një lartësi për të cilën janë të pajtuara palët që janë subjekt i këtij ligji në transaksionet tregtare ndërmjet tyre, siç është paraparë me nenin 8 të këtij ligji;

1.6. **Kamatëvonesë ligjore** - kamatën e thjeshtë për pagesën e vonuar në një lartësi që është e barabartë me shumën e kamatës referente të interesit dhe kamatës që është së paku tetë (8) pikë të përqindjes;

1.7. **Kamata referente e interesit** - për nevoja të këtij ligji, është mesatarja e normës së interesit në kredi të reja në gjashtë muajt e fundit të publikuara nga BQK;

1.8. **Shuma për t'u paguar** - shumën e borxhit kryesor që duhej të ishte paguar brenda periudhës kontraktuese apo ligjore të pagesës, përfshirë tatimet, obligimet doganore, taksat apo ngarkesat që janë përcaktuar në faturë apo në kërkesën e barasvlershme për pagesë;

1.9. **Ruajtja e të drejtës së pronësisë** - marrëveshja kontraktuese, sipas së cilës shitësi e ruan të drejtën e pronësisë mbi mallrat në fjalë derisa çmimi të paguhet në tërësi.

1.10. **Ministria** – ministria përkatëse për tregti dhe industri;

1.11. **BQK** – Banka Qëndrore e Republikës së Kosovës;

Neni 4

Transaksionet midis shoqërive tregtare

1. Në transaksionet tregtare midis shoqërive tregtare, kreditori ka të drejtë në kamatë-vonesë pa pasur nevojë për rikujtim, kur plotësohen kushtet si në vijim:

1.1. kreditori ka përmbushur detyrimet kontraktuese dhe ligjore të tij; dhe

1.2. kreditori nuk e ka marrë shumën e mbetur me kohë, përveç nëse debitori nuk është përgjegjës për vonesën.

2. Në transaksionet tregtare, duhet të zbatohet kamata ligjore në pagesat e vonuara.

3. Kamata referente si pjesë e kamatë-vonesës ligjore do të publikohet nga BQK, çdo gjashtë

muaj më datën 1 shkurt dhe 1 gusht të vitit kalendarik.

4. Në rastet kur BQK nuk e ka publikuar kamatën referente në fuqi, duhet përdorur kamata referente e BQK-së e publikuar së fundi.

5. Kamatë-vonesa ligjore e aplikueshme në transaksionet tregtare është kamata referente, e cila vlen për gjashtë muajt në vijim, duke i shtuar kamatën prej së paku 8 pikë të përqindjes.

6. Kur plotësohen kushtet që janë paraqitur në paragrafin 1 të këtij neni:

6.1. kreditori ka të drejtë në kamatë-vonesë duke filluar nga dita e përfundimit të datës së paraparë për pagesë apo përfundimit të afatit që është përcaktuar në kontratë;

6.2. kur data apo afati për pagesë nuk është përcaktuar në kontratë, kreditori ka të drejtë në kamatë-vonesë pas përfundimit të cilit do afat kohor si në vijim:

6.2.1. tridhjetë (30) ditë kalendarike pas datës së pranimit të faturës apo një kërkesë të barasvlershme për pagesë nga ana e debitorit;

6.2.2. kur data e pranimit të faturës apo kërkesës së barasvlershme për pagesë është e papërcaktuar, tridhjetë (30) ditë kalendarike pas datës së pranimit të mallrave apo shërbimeve;

6.2.3. kur debitori e merr faturën apo kërkesën e barasvlershme për pagesë para pranimit të mallrave dhe shërbimeve, tridhjetë (30) ditë kalendarike pas datës së pranimit të mallrave apo shërbimeve;

6.2.4. kur procedura e pranimit apo verifikimit, me të cilën vërtetohet përshtatshmëria e mallrave dhe shërbimeve është e përcaktuar me kontratë, është e parashikuar me ligj ose në kontratë, si dhe nëse debitori merr faturën ose kërkesë të barasvlershëm për pagesë më parë ose në datën në të cilën ai pranim ose verifikimi i tillë ndodh, duhet të realizohet pagesa brenda tridhjetë (30) ditë kalendarike pas asaj date.

7. Kur procedura e pranimit apo verifikimit, me të cilën vërtetohet përshtatshmëria e mallrave dhe shërbimeve sipas kontratës, ku parashihet sipas kontratës kohëzgjatja maksimale e asaj procedure nuk i tejkalon tridhjetë (30) ditë kalendarike nga data e pranimit të mallrave apo shërbimeve, përveç nëse në kontratë është përcaktuar ndryshe dhe me kusht që kjo të mos jetë e padrejtë ndaj kreditorit siç është përcaktuar në nenin 8 të këtij ligji.

8. Palët kontraktuese do të garantojnë që afati për pagesë që përcaktohet në kontratë nuk i tejkalon gjashtëdhjetë (60) ditë kalendarike, përveç nëse në kontratë janë pajtuar ndryshe shprehimisht dhe me kusht që kjo të mos jetë e padrejtë ndaj kreditorit sipas nenit 8 të këtij ligji.

Neni 5

Transaksionet midis shoqërive tregtare dhe autoriteteve publike

1. Në transaksionet tregtare në të cilat debitori është autoriteti publik, kreditori ka të drejtë në kamatëvonesë ligjore për pagesën e vonuar pas skadimit të afatit që është përkufizuar në paragrafët 3, 4 apo 5 të këtij neni, pa pasur nevojë për rikujtim, kur plotësohen kushtet si në vijim:

1.1. kreditori i ka përmbushur detyrimet kontraktuese dhe ligjore të tij; dhe

1.2. kreditori nuk e ka marrë shumën e mbetur me kohë, përveç nëse debitori nuk është përgjegjës për vonesën.

2. Në transaksionet tregtare, duhet të zbatohet kamatë-vonesa ligjore në pagesat e vonuara, si dhe dërgesat e vonuara për mallra dhe shërbime.

3. Kamata referente si pjesë e kamatës ligjore do të publikohet nga BQK, çdo gjashtë muaj më datën 1 shkurt dhe 1 gusht të vitit kalendarik.

4. Në rastet kur BQK nuk e ka publikuar kamatën referente, në fuqi është kamata referente që BQK e ka publikuar herën e fundit.

5. Kamatë-vonesa ligjore e aplikueshme në transaksionet tregtare është kamata referente e cila vlen për gjashtë muajt në vijim, duke i shtuar kamatën prej së paku 8 pikë të përqindjes.

6. Në transaksionet tregtare në të cilat debitori është autoritet publik:

6.1. periudha për pagesë nuk e tejkalon asnjërin afat kohor si në vijim:

6.1.1. yridhjetë (30) ditë kalendarike pas datës së pranimi të faturës apo një kërkesë të barasvlershme për pagesë nga ana e debitorit;

6.1.2. kur data e pranimi të faturës apo kërkesës së barasvlershme për pagesë është e papërcaktuar, tridhjetë (30) ditë kalendarike pas datës së pranimi të mallrave apo shërbimeve;

6.1.3. kur debitori e merr faturën apo kërkesën e barasvlershme për pagesë para mallrave dhe shërbimeve, tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas datës së pranimi të mallrave apo shërbimeve;

6.1.4. kur procedura e pranimi apo verifikimi, me të cilën vërtetohet përshtatshmëria e mallrave dhe shërbimeve është e përcaktuar me ligj ose me kontratë, si dhe nëse debitori merr faturën ose kërkesë të barasvlershme për pagesë më herët ose në datën në të cilën ai pranim ose verifikimi i tillë ndodh, duhet të realizohet pagesa brenda tridhjetë (30) ditësh kalendarike pas asaj date.

6.2. Data e pranimi të faturës nuk i nënshtrohet ndonjë marrëveshjeje kontraktuese midis debitorit dhe kreditorit.

7. Kohëzgjatja e procedurës së pranimi apo verifikimi që është përcaktuar në paragrafin 6.1.4 të këtij neni, e cila nuk i tejkalon tridhjetë (30) ditë kalendarike nga data e pranimi të mallrave apo shërbimeve, përveç nëse me kontratë apo me ndonjë dokument tjetër është përcaktuar ndryshe, si dhe me kusht që kjo të mos jetë e padrejtë ndaj kreditori konform nenit 8 të këtij ligji.

8. Nëse periudha për pagesë sipas kontratës nuk i tejkalon afatet ligjore sipas paragrafi 6 të këtij neni, përveç nëse palët janë pajtuar shprehimisht dhe me kusht që objektiviteti i saj të arsyetohet, duke marrë parasysh natyrën dhe veçoritë e kontratës, me kusht që ajo, në cilindo rast, të mos i tejkalojë gjashtëdhjetë (60) ditë kalendarike.

Neni 6

Afatet kohore për pagesë

Ky ligj nuk e paragjykon zotësinë e palëve për t'u marrë vesh, duke iu nënshtruar dispozitave relevante të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, mbi afatet kohore në të cilat parashihen këstet për pagesë. Në rastet e tilla, nëse ndonjëri këst nuk paguhet më datën e caktuar, kamata dhe kompensimi që parashihen në këtë ligj llogariten, duke u bazuar vetëm në shumat e papaguara.

Neni 7

Kompensimi i shpenzimeve për rikthim

1. Kur kamatë-vonesa bëhet e arkëtueshme në transaksionet tregtare midis shoqërive tregtare në pajtim më nenin 4 të këtij ligji, dhe në transaksionet tregtare midis shoqërive tregtare dhe autoriteteve publike në pajtim me nenin 5 të këtij ligji, kreditori ka të drejtë të marrë nga debitori po ashtu në kompensim të shpenzimeve për rikthim, një shumë minimale të përcaktuar prej 40.00 (dyzet) eurosh.

2. Shuma fikse që është përmendur në paragrafin 1 të këtij neni është e arkëtueshme pa pasur nevojë për rikujtim dhe si kompensim i shpenzimeve të kreditorit për rikthim.

3. Krahas shumës fikse që është përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, kreditori ka të drejtë ta marrë nga debitori një kompensim të arsyeshëm për çdo shpenzim për rikthim që e tejkalon këtë shumë fikse dhe që është shkaktuar për shkak të vonesës së pagesës nga debitori. Kjo mund t'i përfshijë shpenzimet e shkaktuara, mes tjerash për angazhimin e ndonjë avokati apo përmbartuesi privat.

Neni 8

Kushtet dhe praktikat e padrejta kontraktuese

1. Kushti apo praktika kontraktuese që ka të bëjë me datën e periudhës së pagesës, lartësinë e kamatëvonesës për kompensim të shpenzimeve për rikthim është ose e pa përmbartueshme ose përbën arsye për padi për dëmshpërblim nëse është e padrejtë ndaj kreditorit. Kur përcaktohet nëse një kusht apo praktikë kontraktuese është e padrejtë ndaj kreditorit, duhet të shqyrtohen të gjitha rrethanat e rastit, duke përfshirë:

1.1. çdo devijim të rëndë nga praktika e mirë tregtare që bie ndesh me parimin e mirëbesimit dhe trajtimin e drejtë;

1.2. natyrën e produktit apo shërbimit; dhe

1.3. nëse debitori ka arsye objektive për të devijuar nga dispozita ligjore e kamatëvonesës, nga periudha për pagesë që është përcaktuar në nenin 4 paragrafi 6 të këtij ligji, nenin 5 paragrafët 6 dhe 8 të këtij ligji apo nga shuma fikse që është përcaktuar në nenin 7 paragrafi 1 i këtij ligji.

2. Për qëllimet e paragrafit 1 të këtij neni, kushti apo praktika kontraktuese që nuk merr parasysh kamatëvonesën konsiderohet si e padrejtë.

3. Për qëllimet e paragrafit 1 të këtij neni, kushti apo praktika kontraktuese që nuk merr parasysh kompensimin për shpenzimet e rikthimit që është përcaktuar në nenin 7 të këtij ligji konsiderohet se është e padrejtë.

Neni 9

Transparenca dhe vetëdijësimi

1. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë kujdeset që të ketë transparencë përkitazi me të drejtat dhe detyrimet që dalin nga ky ligj.
2. BQK do ta vë në dispozicion të publikut kamatën referente çdo gjashtë muaj, siç është paraparë në këtë ligj, duke e vënë këtë informacion në dispozicion të të gjitha palëve të interesuara dhe duke e publikuar atë në faqen zyrtare të internetit.
3. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë do të përgatisë publikimet e veçanta, fushatat e promovimit apo çfarëdo mjeti tjetër funksional për të shtuar vetëdijësimin lidhur me mjetet juridike për kamatë-vonesën në mesin e shoqërive tregtare dhe autoriteteve publike.

Neni 10

Ruajtja e të drejtës së pronësisë

Shitësi e ruan të drejtën e pronësisë mbi mallrat derisa ato të paguhen në tërësi, nëse blerësi dhe shitësi janë pajtuar shprehimisht me klauzolën për ruajtjen e drejtës së pronësisë para dorëzimit të mallrave.

Neni 11

Zbatimi përshtatshëmrisht i dispozitave të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve

Në mungesë të dispozitave të përcaktuara me këtë Ligj, zbatohen përshtatshëmrisht dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, me përjashtim të neneve 382 dhe 383.

Neni 12

Dispozitat përfundimtare

1. Dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve që rregullojnë kamatë-vonesën mbeten të zbatueshme për kontratat që janë lidhur, dhe faturat që janë lëshuar para datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji.
2. BQK do të nxjerrë akte nënligjore për kamatë-vonesat sipas nenit 2, nënparagrafi 2.3 të këtij ligji, më së largu gjashtë (6) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 13

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 05/L-110

28 tetor 2016

Shpallur me dekretin Nr. DL-041-2016, datë 15.11.2016 nga Presidenti i Republikës së Kosovës Hashim Thaçi.